



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **VII-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024**.

Seanca mbahet më **26.07.2024 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë: 28.06.2024,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për këmbimin e pronave (ref.ekz),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për suspendimin e vendimit të miratuar 01Nr.060-18364 për rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale.
6. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2024 (ref.drejt.fin),
7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2023 (ref.ekz),
8. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit (ref.ekz),
9. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë 25.06.2024,
10. Informatë nga DKA rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 (ref.DKA),
11. Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me funksionimin e punës në QKMF (ref. drejt. Shëndetësisë),
12. Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave publike në Komunën e Klinës (ref. DSHPE),
13. Informatë mbi realizimin e planit të punës së zyrës së prokurimit janar-qershor 2024 (ref. nga z. e prokurimit),
14. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 060-22364/2024
Klinë, me 26.07.2024 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Fadil Gashi